

# Kimia organike

---

**Kimia organike** është degë e kimisë, që studion përberjen, vetit, strukturën, reaksionet, dhe sintezën e komponimeve organike (komponimeve të karbonit) me rëndësi jetësore. Në komponimet organike të karbonit bëjnë pjesë jo vetëm ato komponime që gjenden në botën e gjallë, por edhe ato komponime që përfitohen me reaksionet e komponimeve inorganike në ato organike) dhe përfitimi i amoniakut nga metani (shëndërimi i komponimeve organike në ato inorganike).

Komponimet organike i karakterizojnë disa veti fizike dhe kimike që i dallojnë nga komponimet inorganike (tretshmerinë, pika e vlimit dhe e shkrirjes, djegëshmëria, struktura kimike, reaksionet kimike) etj. Komponimet organike i paraqesim me formulë molekulare, racionale të strukturës etj. Në kiminë organike bëjnë pjesë: komponimet organike të karbonit, Hidrokarburet, komponimet organike me oksigjen dhe azot (alkoolët) dhe komponimet organike me rëndësi jetësore. Kimia organike luan rol të rëndësishëm për ekonominë, në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Në plejadën e kimistëve të shekullit XIX, Berzeliusi (Berzelius) ishte i pari, i cili kimist që në gjuhën shkencore futi togfjalëshin kimi organike. Ai në vitin 1827 botoi tekstin e parë të kimisë organike.

## *Komponimet organike të karbonit*

---

Kimia organike është degë e kimisë, e cila studion përberjen, strukturën, vetitë, reaksionet dhe sintezën e komponimeve të karbonit. Në kiminë organike nuk merren të gjitha komponimet e karbonit si oksidet e karbonit (CO, CO<sub>2</sub>), karbonate etj. që bëjnë pjesë në kiminë inorganike. Kimia organike si shkencë më vete është themeluar vonë, në gjysmën e parë të shek. XIX.

Kimistët para dyqind vjetësh substancat kimike i ndanin në dy grupe: në substanca inorganike që fitoheshin nga bota jo e gjallë dhe organike që fitoheshin nga bota e gjallë. Kimisti suedez Berzelius për herë të parë në vitin 1806 e përmendi termin kimi organike. Sipas tij komponimet organike përbëhen nga ato elemente, që përbëjnë komponimet inorganike, mirëpo komponimet organike përfitohen vetëm nga organizmat e gjallë. Kjo u quajt ndryshe "teoria vitaliste" (vis-vitalis). Por këtyre mendimeve u dha fund shkencëtari gjerman Friedrich Wöhler ku thotë që ai mund ta fitoi uren nga cianati i amoniut (NH<sub>4</sub>OCN (aq) - nxehje -> CO(NH<sub>2</sub>)<sub>2</sub>(aq)). Tani

numri i komponimeve organike të sintetizuara është shume më i madh (mbi 19 milion sosh). Viti 1829 merret si bazë e fillimit të kimisë organike si shkencë. Termi kimi organike përdoret sot e atë ditë dhe ka të bëjë jo vetëm me komponimet organike por edhe me ato komponime inorganike që mund të kthehen në organike me sintetizim në laborator. Fredrik Voler ne vitin 1828 është kimisti i parë që formon komponimin e parë organik . NH<sub>2</sub> (CO-NH<sub>2</sub>) Lidhja kimike është gjithmone lidhje polare. tek klasifikimi i komponimeve kimiko organike kemi edhe izomerin që ndahet në 2 grupe: izomeria strukturore dhe hapsinore. Lidhja kimike paraqet pjesën me reaktive të një molekule organike.